



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA E KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE/NATIONAL AUDIT OFFICE

1. Emri i Institucionit:	Zyra Kombëtare e Auditimit
2. Titulli:	Auditor për Teknologji Informative
3. Financimi:	Përcaktohet me akt të veçantë
4. Funksioni:	
5. Paga:	
6. Lloji i vendit të punës:	Me kohë të pacaktuar
7. Divizioni:	
8. Departamenti:	
9. Raporton tek:	Drejtori i Departamentit/ Udhëheqësi i ekipit të Auditimit
10. Lokacioni:	Prishtinë

11. Qëllimi i Pozitës:

Auditimi i Teknologjisë Informative nënkupton një ekzaminim të mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së kontrolleve të cilat mbrojnë sistemet e aplikimit të TI për të siguruar besueshmërinë, integritetin dhe disponueshmërinë e sistemeve të TI dhe mirëmbajtjen e informacioneve në këto sisteme.

Auditori për TI do të ofroj përkrahje për ekipet e auditimit në identifikimin e sistemeve informative aktualisht në shfrytëzim, duke analizuar qeverisjen, rrezikun dhe përshtatshmërinë e tyre. Po ashtu, si detyra tjera do të jenë edhe kryerja e vlerësimeve profesionale në implementimin, qeverisjen, operimin, mbrojtjen dhe monitorimin e sistemeve informative në shfrytëzim. Auditori i Teknologjisë Informative i raporton Drejtorit të Departamentit të Auditimit.

12. Detyrat kryesore: (përshkrimi i shkurtër i detyrave kryesore të rëndësishme sipas rëndësise së tyre e po ashtu edhe përcaktimi i përqindjes kohore të nevojshme për secilën detyrë).

Detyra 1: Kryerja e monitorimit të sistemeve informative për të siguruar se janë duke u ndjekur politikat dhe praktikat adekuate për TI; 25 %

Detyra 2: Kryerja e vlerësimit të rreziqeve për sistemet e monitoruara; 25 %

Detyra 3: Kryerja e intervistave me personat përgjegjës si dhe palët e interesit për të mundësuar dhënien e vlerësimit si dhe verifikimin e të dhënave dhe dëshmimeve të pranuar; 15 %

Detyra 4: Verifikimi dhe vlerësimi i operacioneve të ndërlidhura me sistemet e informacionit;	10 %
Detyra 5: Dokumentimi dhe raportimi për të gjeturat dhe dhënien e opinionit dhe rekomandimeve;	10 %
Detyra 6: Përcjellja dhe aplikimi i planit të punës të caktuar nga Udhëheqësi i Ekipit, i cili paraprakisht është i aprovuar nga Drejtori i Departamentit;	5 %
Detyra 7: Ofrimi i ndihmës si mentor/trajnuar për anëtarët e tjerë të ekipit, në mënyrë që çdo anëtar i ofrojë ekspertizën e duhur lidhur me TI për fushën që auditohet;	5%
Detyra 8: Raportimi për punën e kryer në baza të përcaktuara kohore tek nivelet menaxhuese.	5%

13. Përgjegjësitë Mbikëqyrëse (Pozitat që i raportojnë kësaj pozite, nëse ka ndonjë)

Nuk ka

14. Niveli i përgjegjësisë Financiare:

Nuk ka

15. Shkathtësitë e kërkuara: (kualifikimet, përvojat, shkathtësitë tjera dhe aftësitë e kërkuara për këtë vend pune)

- Diplomë fakulteti në fushat relevante të Teknologjisë Informative;
- Përvojë pune profesionale së paku tri (3) vite;
- Certifikim nga fusha e TI-së, në veçanti ato si CISA, CISM, CISSP, ITIL do të kenë përparësi
- Të ketë njohuri rreth sistemeve të sigurisë profesionale të informacionit, menaxhimit të projekteve, me theks të veçantë të projekteve të TI-së, menaxhimin e shërbimeve, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut dhe përshtatshmërisë, si dhe njohuri rreth standardeve dhe praktikave me të mira të punës në fushën e cila ndërlidhet me këtë pozitë.
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale, aftësi të mira komunikimi verbal dhe në të shkruar në gjuhët zyrtare dhe njohuri të mirë rreth gjuhës angleze.

16. Karakteristikat e pazakonta të vendit të punës (rreziqet e pazakonshme në vendin e punës, presionet fizike ose ekspozimi ndaj substancave të rrezikshme ose përdorimi i pajisjeve të cilat paraqesin rrezik dhe që rezultojnë si shkak i vendit të punës apo lokacionit.

17. Nënshkrimet dhe Aprovimet

Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë

<i>Emri:</i>	<i>Nënshkrimi</i>	<i>Data</i>
--------------	-------------------	-------------

Përgjegjësi për Burime Njerëzore

<i>Emri:</i>	<i>Nënshkrimi</i>	<i>Data</i>
--------------	-------------------	-------------

Menaxheri i Lartë Administrativ i Institucionit

<i>Emri:</i>	<i>Nënshkrimi</i>	<i>Data</i>
--------------	-------------------	-------------